



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0167**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim -Kryesuese, Isa Hasni dhe Kimete Gashi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NOVUS SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, me 13/05/2026, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE NOVUS SH.P.K. me nr. 2026/0167 , e datës 19/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.
2. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) sipas vendimeve për këtë aktivitet nr; 2025/1075, 2025/0548, 2025/0060 dhe 2024/0712,, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar "Res Judicata".
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

**- Faktet dhe rrethanat procedurale -**

Me 29.11.2023 MINISTRIA E SHËNDETËSISË duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi, implementimi dhe mirembajtja e sistemit Packs dhe RIS te SISH” me nr. të prokurimit: "206-23-13309-1-1-1".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 3.800.000,00 €.

Me 26.02.2026 MINISTRIA E SHËNDETËSISË duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 03.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 09.03.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.03.2026. “NOVUS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0167, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

#### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “NOVUS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

#### **DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE**

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP)

Neni 1 – Është cenuar qëllimi i ligjit për përdorim të drejtë dhe transparent të fondeve publike.

Neni 1.36 – Oferta e OE përmbush kriteret dhe është tender i përgjegjshëm.

Neni 7 – Është shkelur parimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminimit.

Neni 28 – Janë vendosur kërkesa shtesë përtej Dosjes së Tenderit.

Neni 59 dhe 59(4) – Vlerësimi i ofertës nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Neni 60 – Nuk janë respektuar kriteret për dhënien e kontratës.

Neni 62 – Anulimi i aktivitetit është bërë pa bazë ligjore.

Neni 72 – Sqarimet e OE nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 40.6(b) – Oferta e OE është në përputhje me kërkesat dhe eliminimi është i pabazuar.

Neni 43.5 – Procedura është anuluar pa arsye të ligjshme.

Pretendimet ankimore  
OE Pacs and Workflow System paraqet këtë Ankesë në OSHP kundër Vendimit për Rishqyrtim të Autoritetit Kontraktues të datës 09.03.2026 për aktivitetin e prokurimit me nr. 206-23-13309-1-1-1, me të cilin AK refuzon si të pa bazë Kërkesën e OE PACS and Workflow System për Rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit, duke e vlerësuar ofertën e OE Pacs and Workflow System si të papërgjegjshme, dhe duke shpallur anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 206-23-13309-1-1 si të drejtë dhe të ligjshëm.

Duhet theksuar se Vendimi për anulim përsëritet për herë të pestë, megjithesë OSHP i shpallë të gjitha ankesat e OE PACS and Workflow System si të bazuara, duke rezultuar kështu në një injorancë dhe mospërfillje të AK-së ndaj OSHP-së.

Edhe ky Vendim për Rishqyrtim i AK devijon plotësisht në arsyetim nga Njoftimi i parë për Vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Për më tepër, edhe pretendimet e reja nuk kanë bazë për të shpallur ofertën e OE PACS and Workflow System si të papërgjegjshme.

Po ashtu, AK nuk i ka shqyrtuar në mënyrë substanciale pretendimet e OE PACS and Workflow System, por është kufizuar vetëm në përsëritjen e arsyeve të paraqitura në letrën eliminuese, pa kryer një shqyrtim të mirëfilltë, të arsyetuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Në këtë drejtim, pretendimet ankimore të paraqitura në këtë Ankesë pranë OSHP-së përkojnë plotësisht me ato të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim, të cilat nuk janë adresuar në mënyrë substanciale nga ana e AK-së.

Me rëndësi esenciale, veprimet e Autoritetit Kontraktues paraqesin veprime të paligjshme dhe veprime të cilat refuzojnë të zbatojnë vendimet përfundimtare dhe meritore të OSHP-së, e cila veçse ka vendosur katër (4) herë për të njëjtin tender. Në katër (4) raste, OSHPja, mbështetur edhe nga ana e ekspertit shqyrtues, ka konstatuar se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe rrjedhimisht kualifikohemi për dhënie të Kontratës. Në përputhje me Nenin 131 të LPP-së dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së OSHP, për shkak të refuzimit të Kërkeses për Rishqyrtim prape me date 03.03.2026, kërkojmë edhe masa ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve përgjegjës, kjo për shkak të diskriminimit dhe refuzimit të zbatimit të vendimeve detyruese të OSHP-së. Ndërmarrja e masave ndëshkimore ndaj Autoritetit Kontraktues dhe zyrtarëve të prokurimit gjithashtu është paralajmëruar edhe në vendimin e OSHP me numër 2025/0060 (shih faqe 12 të vendimit).

Për më tepër, në Vendimin 2025/0060, eksperti shqyrtues i ka propozuar panelit shqyrtues që kjo çështje të trajtohet si “res judicata”, pra si çështje e gjykuar. Duke qenë se ky aktivitet i prokurimit ka kaluar nëpër një numër të madh të vlerësimeve nga OSHP dhe në çdo rast është konstatuar se OE ka paraqitur ofertë të përgjegjshme, nuk është më e arsyeshme dhe as e ligjshme që procedura të vazhdojë me të njëjtët hapa të përsëritur. Në këto rrethana, aktiviteti i prokurimit duhet të përmbyllet duke respektuar konstatimet e OSHP-së dhe OE të shpërblehet me kontratë.

AK ka vlerësuar se OE Pacs and Workflow System nuk ka dorëzuar një ofertë të përgjegjshme për këto arsye:

(1) OE nuk ka përmbushur kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nga pika 9.1 dhe 9.2 e Seksionit II – Fleta e të Dhënave të Tenderit, me arsyetimin se nuk është dorëzuar certifikatë e vlefshme CE Klasa IIa sipas Direktivës 93/42/EEC, por është dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb. (2) OE nuk ka dëshmuar mjaftueshëm përvojën për projekte të natyrës së njëjtë dhe implementim multi-site, me arsyetimin se:

? referenca e dorëzuar në kuadër të sqarimeve nuk është lëshuar nga përfituesi real i shërbimit;

? mungon vula/konfirmimi zyrtar;

? datat e deklaruara në listën e referencave nuk korrespondojnë me dokumentet mbështetëse

(1) OE nuk ka përmbushur specifikimet teknike për Central Server – Dell PowerEdge R760xd2, me arsyetimin se:

? bezel-i frontal është “N/A”;

? mungon paneli i kyçshëm frontal;

? nuk është specifikuar sensori i hapjes me alarm;

? moduli 4x SFP28 nuk përfshin transceiver-at.

Në kundërshtim të kësaj, OE Pacs and Workflow System paraqet pretendimet si në vijim:

(1) E ka përmbushur të gjitha kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit, përfshirë kërkesat për kapacitet teknik/profesional dhe specifikimet teknike;

(2) Oferta e OE është e përgjegjshme në kuptim të nenit 1.36 dhe nenit 59(4) të LPP-së;

(3) Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi ekziston ofertë e përgjegjshme dhe nuk është dëshmuar asnjë devijim material apo bazë ligjore që do të justifikonte anulimin.

Të njëjtat pretendime për mos-përmbushje janë ngritur në mënyrë të vazhdueshme nga AK edhe në vendimet e mëparshme për anulim të aktivitetit të prokurimit, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga OSHP si të pabazuara, duke konfirmuar në mënyrë të përsëritur se oferta e OE Pacs and Workflow System është e përgjegjshme. Ky veprim njëkohësisht përbën edhe mosrespektim të vendimeve detyruese të OSHP-së nga ana e AK-së.

Në këto rrethana, OE Pacs and Workflow System kundërshton në tërësi arsyetimin e AK-së dhe thekson se rivlerësimi i përsëritur mbi baza të njëjta faktike dhe juridike është në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe me karakterin detyrues të vendimeve të OSHP-së.

Pretendimi ankimor 1:

OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PLOTËSUAR TË GJITHA PJESËT

OBLIGATIVE TË DOSJES SË TENDERIT

Në këtë ankesë të pestë pranë OSHP-së, OE ri-pohon se ka përmbushur të gjitha pjesët obligative të dosjes së tenderit. Megjithatë, në Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 26.02.2026, AK e rivlerëson ofertën si të papërgjegjshme për këto arsye:

1) Pretendohet se nuk është përmbushur kërkesa për dëshmi të implementimit të sistemit përmes referencave, për shkak se dokumentacioni i dorëzuar nuk është lëshuar nga përfituesi real i shërbimit dhe mungon konfirmimi/vula zyrtare;

2) Pretendohet se referencat e paraqitura nuk përmbushin kërkesën për projekte të natyrës së njëjtë gjatë tre (3) viteve të fundit, për shkak të mospërputhjes së datave të deklaruara në listën e projekteve me dokumentet mbështetëse;

1) Pretendohet se nuk është përmbushur kërkesa për certifikatë CE Klasa IIa sipas Direktivës 93/42/EEC, pasi OE ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb;

2) Pretendohet se oferta nuk përmbush specifikimet teknike për Central Server – Dell

PowerEdge R760xd2, konkretisht:

a) Bezel-i frontal është i shënuar si “N/A” në katalogun e dorëzuar;

b) Nuk është specifikuar panel frontal i kyçshëm dhe sensori i hapjes me alarm;

c) Moduli 4x SFP28 nuk përfshin transceiver-at përkatës..

Pas krahasimit të Njoftimit të datës 05.06.2025 me Njoftimin e datës 26.02.2026, rezulton se AK ka shtuar pretendime të reja për të cilat më parë nuk e ka konsideruar ofertën e OE si të papërgjegjshme. Në njoftimet e mëparshme të AKsë nuk është ngritur pretendimi lidhur me certifikatën CE Klasa IIa, për të cilën OE është konsideruar i përgjegjshëm. Rrjedhimisht, AK nuk e ka vlerësuar ofertën si të papërgjegjshme në bazë të këtyre çështjeve në fazat e mëparshme të vlerësimit.

Duke qenë se AK ka eliminuar OE Pacs and Workflow System për arsye të cilat më parë i ka vlerësuar si të përmbushura, AK është në shkelje të nenit 7 të LPP-së, i cili garanton trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik.

Vlerësimi i përsëritur i ofertës si e papërgjegjshme mbi baza të ndryshme, pa ndryshim të rrethanave faktike, dëshmon qartë për një qasje të padrejtë dhe diskriminuese ndaj OE, dhe me qëllim të eliminimit të tij dhe të anulimit të aktivitetit të prokurimit.

Një veprim i tillë është në kundërshtim edhe me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, i cili përcakton se kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton një ndryshim të rezultatit fillestar, por vetëm korrigjimin e parregullsive të konstatuara.

Në të gjitha instancat e rikthimit në vlerësim nga OSHP për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka ndryshuar vlerësimet e saj mbi ofertën e OE Pacs and Workflow System, duke shtuar arsye të reja eliminimi që nuk kanë qenë objekt i vlerësimit paraprak, gjë që përforcon qëndrimin se AK ka për qëllim të eliminojë ofertën e OE Pacs and Workflow System në çdo mënyrë të mundshme dhe të anulojë aktivitetin e prokurimit.

Në këto rrethana, OE Pacs and Workflow System kundërshton në tërësi arsyetimin e AKsë dhe thekson se oferta e tij është e përgjegjshme, ndërsa pretendimet e ngritura nga AK nuk qëndrojnë dhe nuk mbështeten në bazë ligjore.

Kështu, në vijim do të argumentojmë se OE Pacs and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe si e tillë duhet të shpërblehet me kontratë, për shkak se asnjë nga pretendimet e lartcekura të AK nuk qëndron.

Pretendimi ankimor 2:

## OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PARAQITUR OFERTË TË PËRGJEGJSHME

1) AK, me Njoftimin e datës 26.02.2026, për herë të parë gjatë këtij aktiviteti të prokurimit dhe pas disa cikleve të rivlerësimit, ka vlerësuar se OE nuk ka paraqitur certifikatë të vlefshme që dëshmon se zgjidhja e propozuar është e certifikuar me CE

Klasa IIa sipas Direktivës 93/42/EEC, ndërkohë që OE ka dorëzuar certifikatë CE

Klasa IIb.

AK e konsideron këtë si mosplotësim të një kushti thelbësor të pjesëmarrjes, duke pretenduar se CE Klasa IIb përfaqëson klasifikim të ndryshëm rregullator dhe nuk zëvendëson CE Klasa IIa.

Ky vlerësim është i gabuar si në aspekt procedural ashtu edhe në aspekt material.

(a) Shkelje procedurale – arsye e re eliminimi

Në të gjitha vlerësimet paraprake dhe në katër ciklet e rivlerësimit, përfshirë shqyrtimet nga OSHP, OE asnjëherë nuk është konsideruar ofertë e papërgjegjshme për këtë çështje. Rrjedhimisht, ngritja e kësaj pike për herë të parë në fazën aktuale përbën ndryshim të rezultatit të rivlerësimit. Në përputhje me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton ndryshim të rezultatit fillestar, por vetëm korrigjimin e parregullsisve të konstatuara. AK nuk është e autorizuar të shtojë arsye të reja eliminimi që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi paraprak. Për këtë arsye, ky vendim është i kundërligjshëm në aspekt procedural dhe cenon integritetin e procesit të vlerësimit.

b) Interpretimi literal i Dosjes së Tenderit – “të paktën CE Klasa IIa”

Dosja e Tenderit kërkon që sistemi të jetë i certifikuar si “të paktën CE Klasa IIa”.

Formulimi “të paktën” përfaqëson një prag minimal të pranueshmërisë dhe nuk përbën kufizim ekskluziv në një klasë të caktuar. Në interpretimin juridik dhe teknik, çdo klasifikim i barabartë ose më i lartë se ai i kërkuar përmbush kërkesën minimale. Nëse qëllimi i AK do të kishte qenë kufizimi strikt në CE Klasa IIa, Dosja e Tenderit do të përdorte formulim përjashtues, si “duhet të jetë CE Klasa IIa” apo “vetëm CE Klasa IIa”. Një formulim i tillë nuk ekziston në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, kërkesa e Dosjes së Tenderit është e natyrës minimale dhe jo ekskluzive, ndërsa certifikata CE Klasa IIb e dorëzuar nga OE jo vetëm që përmbush këtë kërkesë, por e tejkalon atë, duke përfaqësuar një klasifikim më të avancuar dhe me standard më të lartë rregullator

(c) CE Klasa IIB përfaqëson nivel më të lartë rregullator Certifikata e dorëzuar nga OE është CE Klasa IIB, e lëshuar nga Notified Body (TÜV Rheinland) në përputhje me legjislacionin evropian për pajisje mjekësore. Pajisjet e klasifikuara si Klasa IIB i nënshtrohen procedurave më rigorozë të vlerësimit të konformitetit sesa Klasa IIA, duke përfshirë:

? auditime më të detajuara,

? vlerësim më të thelluar të dokumentacionit teknik,

? mbikëqyrje më intensive nga organi i njoftuar.

Rrjedhimisht, CE Klasa IIB jo vetëm që plotëson prapësin minimal “të paktën CE Klasa IIA”, por garanton nivel më të lartë sigurie dhe konformiteti.

Në këto rrethana, refuzimi i një certifikate të nivelit më të lartë për përmbushjen e një kërkesë minimale përbën interpretim të gabuar dhe në kundërshtim me logjikën teknike dhe rregullatore.

(d) Parimi i ekuivalencës – neni 28 paragrafi 6 i LPP-së

Në përputhje me nenin 28 paragrafi 6 të LPP-së, nëse një tenderues demonstron se zgjidhja e propozuar në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e specifikimit teknik, Autoriteti Kontraktues nuk mund të refuzojë tenderin për shkak të formulimit literal të specifikimit.

Në këtë rast, OE jo vetëm që ka ofruar zgjidhje ekuivalente, por ka ofruar zgjidhje me nivel më të lartë konformiteti sesa kërkesa minimale. Eliminimi për shkak se është dorëzuar certifikatë CE Klasa IIB përbën interpretim formalist, joproporcional dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të drejtë dhe proporcionalitetit.

Rrjedhimisht, pretendimi i AK-së lidhur me kërkesën për CE Klasa IIA përbën një arsye të re eliminimi, e ngritur për herë të parë në këtë fazë të procedurës, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, i cili nuk lejon ndryshim të rezultatit fillestar apo shtim të arsyeve të reja për skualifikim, përveç korigjimit të parregullësive të konstatuara.

Për më tepër, Dosja e Tenderit kërkon shprehimisht “të paktën CE Klasa IIA”, formulim i cili përfaqëson një prag minimal pranueshmërie dhe jo një kufizim ekskluziv në një klasë të caktuar. Në këtë kuptim, certifikata CE Klasa IIB e dorëzuar nga OE jo vetëm që përmbush këtë kërkesë, por e tejkalon atë, duke përfaqësuar një nivel më të lartë të klasifikimit dhe përputhshmërisë rregullatore. Në këto rrethana, eliminimi i OE mbi këtë bazë është i pabazuar dhe i kundërligjshëm, si në aspekt procedural ashtu edhe në aspekt material. 1) AK, edhe në këtë fazë, pretendon se OE nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 9.1 dhe 9.2 të Seksionit II të FTD-së, duke vlerësuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme ligjërisht të vlefshme për të demonstruar se produkti i ofruar është implementuar në disa arkitektura multi-site.

AK konteston se dokumentacionit të ofruar nga OE i mungon vula zyrtare dhe se nuk përmban dëshmi të drejtpërdrejtë nga marrësi i shërbimeve, konkretisht Ministria e Shëndetësisë së Lituanisë. Po ashtu, pretendohet se dokumenti i dorëzuar në kuadër të sqarimeve nuk është lëshuar nga vetë Ministria, por nga një anëtar i konsorciumit, dhe se për rrjedhojë nuk plotëson kërkesën për referencë nga klienti përfitues. Ky vlerësim është i pabazuar si në aspekt faktik ashtu edhe në aspekt juridik. Së pari, Dosja e Tenderit nuk përmban kërkesë që referenca për implementimin e produktit të jetë e vulosur apo e nënshkruar në një formë të caktuar nga klienti

përkatës. Kërkesa e përcaktuar në FTD është që OE të demonstrojë implementimin përmes një shembulli të sistemit të implementuar në disa lokacione dhe të ofrojë informacion kontakti për verifikim. Nuk është paraparë asnjë formë e detyrueshme dokumentare (si vulë zyrtare apo format i standardizuar i referencës).

Së dyti, dokumentacioni i dorëzuar nga OE për projektin e implementuar në Lituani përmban përshkrimin e arkitekturës multi-site, integrimin e realizuar si dhe informacionin kontaktues të personit përgjegjës, duke mundësuar verifikimin e drejtpërdrejtë nga ana e AK-së. Rrjedhimisht, OE ka përmbushur plotësisht kërkesën për referencë të verifikueshme, ashtu siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Fakti që referenca është lëshuar nga një anëtar i konsorciumit nuk e cenon vlefshmërinë e saj, përderisa përmbajtja e saj është e verifikueshme dhe përmban informacionet e kërkuara. Kërkesa e AK-së që referenca të jetë e vulosur nga klienti, ndonëse një kërkesë e tillë nuk figuron në Dosjen e Tenderit, përbën shtim të kriteresh pas hapjes së ofertave, në kundërshtim me nenin 60.2 të LPP-së, i cili ndalon ndryshimin apo shtimin e kriterëve të kualifikimit pas hapjes së ofertave. Sa i përket kërkesës për implementimin multi-site sipas pikës 9.2 të FTD-së, nga përmbajtja e Dosjes së Tenderit rezulton qartë se nuk është kërkuar paraqitja e një liste kontratash, por demonstrimi i të paktën një sistemi të implementuar në disa lokacione, së bashku me përshkrimin e detajuar dhe informacionin kontaktues për verifikim. OE ka dorëzuar pikërisht këto elemente: përshkrimin e arkitekturës multi-site dhe të dhënat kontaktuese të personit përgjegjës, duke mundësuar verifikimin nga ana e AK-së. Çdo interpretim që e zgjeron këtë kërkesë në obligim për paraqitje të listave formale të kontratave apo referencave të vulosura nga klienti përfitues përbën tejkalim të kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe zgjerim të paligjshëm të kriterëve të kualifikimit.

Është me rëndësi të theksohet se kjo pikë – përkatësisht përmbushja e kërkesave sipas pikave 9.1 dhe 9.2 – është trajtuar në mënyrë të përsëritur në të gjitha vendimet e OSHP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe është konsideruar si e përmbushur nga OE. Në katër vendimet e OSHP-së, kjo çështje është analizuar dhe OE është vlerësuar si konform në këtë aspekt. Rrjedhimisht, ngritja e së njëjtës çështje në këtë fazë, pa rrethana të reja faktike apo ligjore, përbën jo vetëm rivlerësim të tejkaluar të një çështjeje tashmë të shqyrtuar, por edhe cenim të drejtpërdrejtë të parimit të sigurisë juridike dhe të karakterit detyrues të vendimeve të OSHP-së.

Për këto arsye, oferta e OE Pacs and Workflow System është plotësisht e përgjegjshme edhe në aspektin e përmbushjes së pikave 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, dhe kjo çështje nuk mund të përdoret si bazë për eliminim. 1) AK pretendon se OE nuk ka ofruar dëshmi për realizimin e projekteve të natyrës së njëjtë gjatë tre (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke argumentuar se datat e deklaruara në listën e referencave nuk korrespondojnë me dokumentet mbështetëse të dorëzuara në fazën e sqarimeve. Ky pretendim është i pabazuar si në aspekt faktik ashtu edhe juridik. OE në ofertën fillestare ka deklaruar se projekti përkatës ka filluar më 10.12.2021 dhe është në vazhdim (“ongoing”). Termi “ongoing” i referohet vazhdimësisë së kontratës për mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse pas implementimit fillestar, ndërsa implementimi i sistemit dhe hyrja në prodhim janë realizuar në dhjetor 2021. Kjo është sqaruar qartë edhe në përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim nr. 4 të AK-së, ku OE ka theksuar se faza e implementimit është përfunduar dhe sistemi është aktivizuar në dhjetor 2021, ndërsa vazhdimësia lidhet vetëm me mirëmbajtjen. Referenca e bashkëngjitur nga pala përfituese në Zelandë të Re konfirmon implementimin e suksesshëm të projektit në dhjetor 2021, brenda periudhës trevjeçare

të kërkuar nga Dosja e Tenderit. Për më tepër, dokumentacioni i dorëzuar përmban titullin e projektit, përshkrimin, vlerën, periudhën e realizimit dhe të dhënat kontaktuese për verifikim, në përputhje të plotë me kërkesat e pikave 9.1 dhe 9.2 të Seksionit II të DT-së. Fakti që kontrata vazhdon në formë mirëmbajtjeje nuk krijon asnjë mospërputhje me datën e implementimit. Përkundrazi, hyrja në prodhim në dhjetor 2021 përputhet plotësisht me kriterin kohor të kërkuar nga Dosja e Tenderit. Nuk ekziston asnjë kontradiktë materiale ndërmjet dokumenteve të dorëzuara. Rrjedhimisht, interpretimi i AK-së përbën një lexim selektiv dhe të shkëputur nga konteksti kontraktual, duke injoruar fazat standarde të projekteve të kësaj natyre (implementim dhe mirëmbajtje). Veçanërisht theksojmë se kjo çështje është trajtuar tashmë në katër (4) vendime të OSHP-së në këtë aktivitet të prokurimit, ku është konstatuar se OE ka përmbushur kërkesat lidhur me përvojën dhe projektet e ngjashme. Për rrjedhojë, kjo pikë është konsideruar e përmbushur dhe oferta e OE është vlerësuar si e përgjegjshme, andaj nuk mund të rihapet apo të rivlerësohet në mënyrë të ndryshme pa cenuar parimin e sigurisë juridike dhe detyrueshmërisë së vendimeve të OSHP-së.

1) AK ka rivlerësuar ofertën si të papërgjegjshme duke kontestuar përputhshmërinë e katalogut të dorëzuar nga OE me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT). Megjithatë, katalogu i paraqitur nga OE është në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara në DT.

a) AK konteston përputhshmërinë e serverit të ofruar nga OE për Serverin Qendror, duke iu referuar kërkesës për “opcion për panel frontal të kyçshëm”. Sipas AK-së, serveri Dell PowerEdge R760xd2 nuk e përmbush këtë kërkesë. Ky pretendim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit. Modeli Dell PowerEdge R760xd2 i ofruar nga OE është pjesë e familjes së serverëve Dell PowerEdge R760 dhe mbështet opsionin për front bezel (panel frontal të kyçshëm). Kjo konfirmohet në dokumentacionin zyrtar të prodhuesit Dell, përfshirë manualin për instalimin dhe heqjen e front bezel-it për serinë R760, si dhe në udhëzuesin teknik të platformës përkatëse. Manuali zyrtar i Dell për heqjen e front bezel-it për serinë R760:

[https://www.dell.com/support/manuals/en-us/oth-r760/per760\\_ism\\_pub/removingthe-front-bezel?guid=guid-2885d164-fc59-42dd-ac07-739036289a57&lang=en-us](https://www.dell.com/support/manuals/en-us/oth-r760/per760_ism_pub/removingthe-front-bezel?guid=guid-2885d164-fc59-42dd-ac07-739036289a57&lang=en-us)

Udhëzuesi teknik i platformës: [https://i.dell.com/sites/csdocuments/Product\\_Docs/en/dell-emc-poweredger740xd2-technical-guide.pdf](https://i.dell.com/sites/csdocuments/Product_Docs/en/dell-emc-poweredger740xd2-technical-guide.pdf)

Rrjedhimisht, serveri i ofruar mbështet opsionin për panel frontal të kyçshëm, në përputhje me formulimin “must have an option” të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Faqe 26 e dokumentit të paraqitur Udhëzuesi teknik i platformës:

Përkatësisht, në faqen zyrtare të prodhuesit DELL, përcaktohet se: “The Dell PowerEdge R760xd2 server features a lockable front bezel designed to enhance physical security by restricting unauthorized access to the drive bays and system controls. This bezel can be secured using a key lock mechanism, ensuring that only authorized personnel can access the servers front components.” Fakti që në disa broshura bazë ose konfiguratorë mund të figurojë shënimi “N/A”

nuk nënkupton mungesë të opsionit teknik, por vetëm që bezel-i nuk është pjesë standarde e konfigurimit fillestar të shasisë “xd2”. Në katalogët zyrtarë të pjesëve dhe dokumentacionin teknik të Dell Technologies ekzistojnë bezela opsionale (p.sh. Security Bezel ose LCD Bezel), të

disponueshme për platformën Dell PowerEdge R760, përfshirë variantin Dell PowerEdge R760xd2. Këto aksesore mund të specifikohen dhe porositen në momentin e konfigurimit final ose përmes kanaleve të autorizuara të pjesëve. “Standard”, “xs”, “xa” dhe “xd2” (<https://infohub.delltechnologies.com/eses/p/poweredge-xs-vs-standard-vs-xa-vs-xd2/>), modeli R760xd2 është variant i platformës R760 dhe ndan të njëjtën arkitekturë chassis 2U. Rrjedhimisht, opsionet e sigurisë fizike të platformës R760 janë të aplikueshme edhe për variantin

R760xd2. Për këtë arsye, mungesa e bezel-it në konfigurimin bazë nuk nënkupton mungesë të përputhshmërisë teknike me kërkesën e Dosjes së Tenderit, e cila kërkon ekzistencën e “opsionit” për panel frontal të kyçshëm. Bëhet fjalë për një aksesor opsional (optional accessory), i disponueshëm për porosi, dhe jo për element të detyrueshëm standard në konfigurimin fillestar. Prandaj, interpretimi i AK-së përbën një lexim formalist dhe të pasaktë të kërkesës teknike, duke e trajtuar një opsion si element të detyrueshëm të konfigurimit fillestar

Veçanërisht theksojmë se kjo çështje është trajtuar dhe konsideruar si e përmbushur në katër (4) vendime të OSHP-së në këtë aktivitet të prokurimit. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të rihapet apo të rivlerësohet ndryshe në këtë fazë, pasi do të cenonte sigurinë juridike dhe detyrueshmërinë e vendimeve të organit kompetent të shqyrtimit.

a) Sa i përket pjesës së ofrimit të modulit 4 x 10/25GbE SFP28, bazuar në ofertën teknike të dorëzuar nga OE, është specifikuar qartë se moduli përfshin 4 porta 10/25GbE SFP28, duke përfshirë edhe SFP transceiver-ët përkatës, në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Shih më poshtë ofertën e dorëzuar nga OE për këtë komponentë. Në specifikim thuhet: “Must have at least: 1 module with at least 4 x 10/25GbE, SFP28 ports with included appropriate SFP transceivers.” Në ofertën e dorëzuar nga OE është paraqitur komponenti: Broadcom 57504 Quad Port 10/25GbE SFP28 OCP NIC 3.0, i cili plotëson kërkesën për 4 porta 10/25GbE SFP28 dhe përfshin transceiver-ët përkatës. Rrjedhimisht, në këtë pikë OE Pacs and Workflow System ka përmbushur plotësisht kërkesën teknike, pasi moduli i ofruar i përgjigjet specifikimit minimal të kërkuar. Po ashtu, për të njëjtën pikë, edhe OSHP, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik e kanë konsideruar ofertën si të përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Gjithashtu, duke qenë se në vendimin e fundit të OSHP është urdhëruar rivlerësimi i ofertës dhe kjo pikë është trajtuar e përmbushur dhe e përgjegjshme, atëherë ajo nuk duhet të konsiderohet më si çështje e hapur apo e diskutueshme nga Autoriteti Kontraktues.

Në momentin kur organi kompetent i shqyrtimit administrativ ka konstatuar se moduli 4 x 10/25GbE SFP28, përfshirë transceiver-ët përkatës, është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe ka urdhëruar rivlerësimin duke e konsideruar këtë pikë të përmbushur, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të veprojë në përputhje me atë vendim. Rrjedhimisht, çdo riinterpretim apo rihapje e kësaj çështjeje në fazën e rivlerësimit përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe të detyrueshmërisë së vendimeve të OSHP-së.

a) Sa i përket pretendimit se “nuk specifikohet sensori i hapjes me alarm (intrusion detection sensor), element thelbësor i sistemit të sigurisë”, theksojmë se kjo çështje është trajtuar tashmë në mënyrë eksplicite në vendimin e OSHP nr. 2025/1075. Në arsyetimin e AK-së është përmendur mungesa e këtij elementi si pjesë e pretendimeve për mospërputhje teknike, mirëpo eksperti teknik i angazhuar nga OSHP ka konstatuar, bazuar në dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit Dell, se serveri i ofertuar Dell PowerEdge R760xd2 ofron opsionin për “intrusion

detection sensor” dhe përmbush kërkesat e sigurisë fizike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, kjo çështje është vlerësuar dhe mbyllur si e pabazuar nga organi kompetent shqyrtues, andaj nuk mund të riinterpretohet apo të përdoret sërish si arsye eliminimi në fazën e rivlerësimit.

Pretendimi ankimor 3:

NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE QË TË ANULOHE

AKTIVITETI I PROKURIMIT

Kjo çështje është shqyrtuar tashmë katër (4) herë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe në secilin rast është konstatuar se oferta e OE Pacs and Workflow System është e përgjegjshme dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së. Përsëritja e të njëjtave arsye për eliminim, pas këtyre vendimeve, përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe të detyrueshmërisë së vendimeve të OSHP-së.

Duke qenë se vendimet e OSHP-së janë përfundimtare në procedurë administrative dhe të detyrueshme për palët, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të veprojë në përputhje me to, duke shpallur OE fitues dhe duke e shpërblyer me kontratë, e jo të riinterpretojë apo rihapë çështje tashmë të trajtuara dhe të vlerësuara. Veprimet e AK-së në këtë fazë përbëjnë devijim nga konstatimet e qarta të OSHP-së dhe cenojnë parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, kërkohet që kjo çështje të trajtohet si ‘res judicata, në kuptim të nenit 105 të LPP-së dhe nenit 67 të Rregullores për Prokurim. Bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkohet nga OSHP që, pas shqyrtimit të kësaj Ankese, të merr:

VENDIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar Ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik PACS and Workflow System.

II. ANULOHEN Vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 26.02.2026, për anulim të aktivitetit të prokurimit me numër 206-23-13309-1-1-1, si dhe Vendimi për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim i datës 09.03.2026, dhe të shpërblehet OE PACS and Workflow System me kontratë.

III. SHPËRBLEHET me kontratë Operatori Ekonomik PACS and Workflow System, si ofertues i përgjegjshëm dhe ekonomikisht i favorshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimet e juaja ankimore janë trajtuar nga AK, pas shqyrtimit të tyre mund të konstatojmë se këto pretendime janë të pabazuara dhe AK-MSh qëndron pas vendimit të datës 26.02.2026, si dhe i rikonfirmon arsyet e eliminimit të ofertës tuaj të përshkruara në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Oferta juaj është e papërgjegjshme, komisioni vlerësues në raportin e rivlerësimit i ka potencuar arsyet e eliminimit të ofertës tuaj si në vijim:

Lidhur me kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Një certifikatë e vlefshme që dëshmon se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe

komunikimit të fotografive është e çertifikuar me CE Klasa IIa sipas Direktivës së Pajisjeve Mjekësore 93/42 EEC – shih kriterin e DT. Figura 1 paraqet dëshminë e kërkuar dokumentare. Në kuadër të vlerësimit të kapacitetit teknik dhe profesional, në kuptim të nenit 69 të LPP-së, dosja e tenderit ka përcaktuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të detyrueshme si kriter kualifikues dorëzimin e një certifikate të vlefshme që vërteton se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe komunikimit të fotografive është e certifikuar me CE Klasa IIa, në përputhje me Direktivën e Pajisjeve Mjekësore 93/42/EEC. Kjo kërkesë përbën kusht thelbësor të pjesëmarrjes dhe nuk lë hapësirë për interpretim të zgjeruar apo për pranimin e dokumentacionit alternativ. Pra, dosja e tenderit kërkon një certifikatë të caktuar si dëshmi kualifikuese/teknike; ajo bëhet pjesë e kushteve detyruese dhe, sipas nenit 59(4) të LPP dhe nenit 40.6(b) të RRPP, tenderi është i përgjegjshëm vetëm nëse përputhet plotësisht me kërkesat e dosjes së tenderit.

Megjithatë, Operatori Ekonomik ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb, e cila përfaqëson një klasifikim të ndryshëm rregullator, me procedura të veçanta të vlerësimit të konformitetit dhe me status juridik të pavarur nga Klasa IIa. Edhe pse të dyja klasat rregullohen nga e njëjta direktivë, ato nuk janë të ndërsjella dhe as të zëvendësueshme, pasi certifikimi në një klasë nuk nënkupton automatikisht përmbushjen e kërkesave të klasës tjetër. Në mungesë të një dispozite të shprehur në dosjen e tenderit që lejon ekuivalencë ose pranim të klasave alternative, Autoriteti Kontraktues është i detyruar ligjërisht të zbatojë kriteret e përcaktuara paraprakisht pa devijime, në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike të sanksionuara në Ligjin për Prokurimin Publik. Dallimi ndërmjet klasës së kërkuar dhe asaj të dorëzuar përbën devijim material që prek pranueshmërinë e dokumentit të kërkuar, sipas nenit 59(2) të LPP dhe nenit 38.2 të RRPP. Për rrjedhojë, kjo mangësi është materiale dhe e bën ofertën të pa-përgjegjshme (LPP 1.36), duke imponuar moskualifikim. Figura 2: Operatori Ekonomik ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIb. Figura 2.1: Certifikatë CE Klasa IIb.

Sa i përket pikave 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: OE duhet të demonstrojë se produkti i ofruar është implementuar në disa arkitektura me shumë faqe. Të paktën një shembull i instalimeve në shumë vende (lokacione) duhet të dorëzohet së bashku me përshkrimin e detajuar që ilustron madhësinë e instalimit, integrimin e realizuar dhe arkitekturën e sistemit të zbatuar. Duhet të jepet informacioni i kontaktit që mund të kërkohej si provë. MSH ka të drejtë të skualifikojë OE nëse përgjigja nga referencat nuk është e kënaqshme. Kërkesat e DT-së për referenca të projekteve të ngjashme dhe për implementim multi-site janë kërkesa për aftësi teknike/profesionale në kuptim të nenit 69 të LPP-së dhe mosplotësimi aktivizon detyrimin e skualifikimit sipas nenit 67(2). Oferta konsiderohet “e përgjegjshme” vetëm kur është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e DT-së (LPP 59(4) dhe përkufizimi 1.36), kështu që një referencë e paautentifikuar, jo e verifikueshme ose me mospërputhje faktike (p.sh. data kontradiktore) nuk mund të trajtohet si “devijim i vogël”. RRPP 001/2022 e definon pajtueshmërinë si përmbushje pa largime thelbësore; largimet thelbësore janë ato që prekin parametrat/cilësinë/ekzekutimin e kontratës, prandaj mosdëshmimi i përvojës së kërkuar është devijim material.

Çdo kundërshtim se “s qarimi është teknik” rrëzohet sepse LPP 59(2) dhe RRPP 38.2 ndalojnë çdo ndryshim material të tenderit nëpërmjet sqarimeve. Edhe kur ftohet për plotësim apo qartësim sipas nenit 72, kjo nuk lejon krijim faktesh të reja pas afatit dhe duhet të zbatohet në kushte të barabarta (LPP 7) dhe pa ndryshim kriteresh (RRPP 40.2). Për rrjedhojë, mangësitë në referenca janë materiale (jo formale) dhe imponojnë moskualifikim si tender i pa-përgjegjshëm. Figura 3: Analiza nga Eksperti i OSHP.

Nga analiza materiale dhe formale e dokumentacionit të paraqitur rezulton se kjo kërkesë nuk është përmbushur, për faktin se projekti i referuar fillimisht nuk është përfshirë në listën e projekteve të përfunduara të dorëzuar nga OE, ndërsa dokumenti i paraqitur në kuadër të sqarimeve nuk është lëshuar nga përfituesi i shërbimit, në këtë rast Ministria e Shëndetësisë së Lituanisë, por nga një anëtar i konsorciumit. Kjo situatë bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesën eksplicite të AK që referenca të jetë e lëshuar nga klienti përfitues. Për më tepër, dokumentacionit i mungon vula zyrtare dhe konfirmimi i drejtpërdrejtë, elemente këto esenciale për të garantuar autenticitetin, vlefshmërinë juridike dhe besueshmërinë e dëshmisë së paraqitur.

Në vijim, lidhur me kërkesën për dëshmi të projekteve të natyrës së njëjtë gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit, OE ka qenë i obliguar të paraqesë një listë të kontratave të ekzekutuara, me specifikim të qartë të titullit të kontratës, shumës financiare, datës së fillimit dhe përfundimit, përfituesit, si dhe referenca ose certifikata zyrtare që dëshmojnë performancën. Gjatë rivlerësimit është konstatuar se datat e deklaruara në listën e referencave nuk korrespondojnë me dokumentet mbështetëse të dorëzuara, ndonëse në vlerësimet paraprake është pretenduar e kundërta. Konkretisht, OE ka deklaruar se projekti ka filluar më 10/12/2021 dhe është “ongoing”, ndërsa në dokumentin e dorëzuar pas kërkesës për sqarim figuron se projekti është implementuar në dhjetor 2021, pa asnjë përputhje me datën e deklaruar fillimisht. Figura 4: Dosja e Tenderit.

Dokumenti i ofruar “në kuadër të sqarimeve” nuk është lëshuar nga përfituesi real (autoriteti përkatës publik), por nga anëtar i konsorciumit, dhe mungon vula/konfirmimi. Në terma të LPP-së, kjo bie jashtë provës tipike të nenit 69 (certifikatë nga autoritet publik/dokument nga blerësi real) dhe nuk e përmbush minimumin e kërkuar për verifikim të kapacitetit. Mospërputhja e datave “ongoing” kundrejt “implementuar në dhjetor 2021” është element faktik që prek identitetin dhe kohëzgjatjen e performancës së deklaruar. Nëse korrigjohet pas afatit me dokument tjetër, kjo përbën ndryshim material në kuptim të ndalimit të sqarimeve (neni 59(2) dhe neni 38.2). Duke qenë se dëshmia e multi-site dhe listimit të projekteve është kërkesë e DT-së, ndërsa prova e paraqitur nuk plotëson standardin e nenit 69 dhe nuk mund të “rregullohet” pas afatit pa ndryshim material (neni 59(2), neni 38.2), oferta bie në kategorinë e “tenderit të pa-përgjegjshëm” (përkufizimi 1.36) dhe duhet të refuzohet.

Specifikimet teknike të DT-së janë kërkesa obligative; sipas LPP nenit 28 dhe RRPP 001/2022, tenderi duhet të jetë në pajtueshmëri teknike me përshkrimin/specifikimet e DT-së për t’u konsideruar i përgjegjshëm (RRPP 40.6(b)). Lidhur me specifikimin teknik për pajisjet (Technical Specification for Hardware), OE ka dorëzuar katalogët zyrtarë të markës DELL për Regional Servers (Dell EMC PowerEdge T550), 1x Central Server (Dell PowerEdge R760xd2), duke deklaruar se pajisja përmbush kërkesat. Megjithatë, krahasimi me kërkesat e dosjes së tenderit ka evidentuar mospërputhje të rëndësishme. Për Central Server, modeli Dell PowerEdge R760xd2 nuk përmbush kriteret obligative, pasi: Bezel-i frontal nuk është i përfshirë (“Bezel: N/A”), duke cenuar sigurinë fizike të serverit dhe parandalimin e qasjes së paautorizuar në disqet e përparme; paneli frontal i bllokueshëm mungon, një kërkesë kryesore e dosjes për sigurinë fizike; sensori i hapjes me alarm nuk është specifikuar, i cili është element thelbësor i sistemit të sigurisë; kartela rrjetëzuese me 4x SFP28 porte nuk përfshin transceiver-at e kërkuar, duke mos plotësuar funksionalitetin minimal 10/25GbE.

Për më tepër, nga analiza e ekspertit të OSHP-së rezulton se referenca e përdorur nga eksperti për të justifikuar përputhshmërinë i referohet një katalogu tjetër të modelit Dell PowerEdge

R760, i cili nuk është paraqitur fillimisht në dosjen e tenderit, ku theksojmë se në dosje është paraqitur qartë katalogu Dell PowerEdge R760xd2. Figura 5: Analiza nga Eksperti i OSHP për Technical Specification. Figura 6: Specifikimet teknike të detajuara që duhet të plotësohen nga ofertuesit. Figura 7: Oferta nga OE, katalogu i cili tregon qartë se Bezel është Not Available (jo i disponueshëm), e cila duket qartë në katalog, linku [poweredge-r760xd2-spec-sheet.pdf](#).

Ne si Komision kemi arritur në këtë konkluzion lidhur me propozimin për Central Server – Dell PowerEdge R760xd2: paneli frontal i bllokueshëm mungon, që ishte një nga kërkesat kryesore për sigurinë fizike të serverit; bazuar në katalogun e ofruar, kartela rrjetëzuese ka 4x SFP28 porte për 10/25GbE, por nuk përfshin transceivers dhe përmendet vetëm sloti OCP; kjo nuk plotëson kërkesën e dosjes për konfigurim të plotë të rrjetëzimit 10/25GbE; nuk specifikohet sensori i hapjes me alarm (intrusion detection sensor), element thelbësor i sistemit të sigurisë. Mungesa e elementeve të sigurisë fizike dhe mosplotësimi i parametrave të rrjetëzimit përbëjnë “largime thelbësore” sipas RRPP 40.7, sepse afektojnë cilësinë, sigurinë dhe ekzekutimin e kontratës. Si rrjedhojë, oferta bie në përkufizimin e tenderit të pa-përgjegjshëm (LPP 1.36) dhe nuk mund të trajtohet si devijim i vogël i korigjueshëm sipas LPP 59(4). Pretendimi se “rregullohet me sqarim” përjashtohet nga LPP 59(2) dhe RRPP 38.2; neni 72 lejon vetëm qartësim/plotësim të dokumenteve të paraqitura, jo plotësim të vetive/specifikimeve hardware që mungojnë. Prandaj, mospërputhjet hardware janë materiale (jo formale) dhe imponojnë moskualifikim si tender i pa-përgjegjshëm. Për rrjedhojë, mospërputhjet e identifikuar janë substanciale dhe të papranueshme, nuk mund të korigjohen pas afatit dhe nuk mund të pranohen si referencë ose provë e përputhshmërisë. Pranimi i ofertës në këto kushte do të përbente shkelje të dispozitave të LPP-së dhe do të cenonte integritetin, ligjshmërinë, transparencën dhe barazinë në procesin e prokurimit publik.

Nuk qëndron pretendimi juaj ankimor 1 dhe 2 për arsye të reja teknike për eliminim. Rivlerësimi i AP është bërë nga komisioni i ri i caktuar me vendim të ZKA-së, të cilët e kanë shqyrtuar komplet lëndën dhe dy anëtarët si profesionistë të teknologjisë i kanë përshkruar gjetjet e tyre teknike. AK-MSh i ka dhënë besimin e vet komisionit vlerësues, të cilët e kanë bërë rivlerësimin bazuar në kërkesat e NJK dhe DT, si dhe specifikave teknike të domosdoshme të kërkuara në Aneks 1 të DT. AK nuk ka shtuar kritere apo kërkesa jashtë DT, andaj vendimi ynë është në harmoni me dispozitat ligjore si në vijim: bazuar në nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Bazuar në nenin 40.12 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.

Nuk qëndron pretendimi juaj ankimor 3 për arsyen e anulimit të AP, që sipas jush AK e ka anuluar aktivitetin në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit, meqenëse AP është anuluar për mungesë të ofertave të përgjegjshme, sipas pikës b të nenit 43.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik: Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm. AK-MSh e ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr. 2025/1075 të datës 16.01.2026 duke e kryer rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit siç është kërkuar nga ky vendim. Ri-vlerësimi i AP është bërë nga komisioni i ri i caktuar me vendim të ZKA-së, të cilët e kanë shqyrtuar komplet lëndën dhe dy anëtarët si profesionistë të teknologjisë i kanë përshkruar gjetjet e tyre teknike. AK-MSh i ka dhënë besimin e vet komisionit vlerësues. Komisioni vlerësues ka rekomanduar anulimin e

aktivitetit duke konstatuar se oferta juaj GOE PACS and Workflow System është e papërgjegjshme si në aspektin administrativ ashtu edhe në aspektin teknik. AK-MSh e konsideron këtë aktivitet të mbyllur, duke i hapur rrugë ri-fillimit të një procedure të re të prokurimit për këtë projekt madhor, me kërkesa dhe kushte më të përshtatshme, më konkurruese për të gjithë OE të interesuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0167, ndërsa me datë 15.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0167, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e NOVUS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0167 ka vlerësuar si në vijim:

GOE (“Pacs and Workflow System”) ankues të pakënaqur me vendimin e AK-së të datës 26.02.2026, përkatësisht Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, më datë 03.03.2026, ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim në AK.

Pas shqyrtimit, AK më datë 09.03.2026 ka nxjerrë Vendimin për Refuzimin e kësaj kërkesë, duke lënë në fuqi njoftimin paraprak të datës 26.02.2026.

Lidhur me këtë aktivitet prokurimi, Paneli Shqyrtues ka trajtuar deri më tani katër ankesa të parashtruara nga i njëjti ankues, për të cilat janë nxjerrë vendimet: 2025/1075, 2025/0548, 2025/0060 dhe 2024/0712.

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka përcaktuar mangësitë apo arsyet e eliminimit. Eksperti sqaron se pretendimet ankimore lidhur me arsyet e tjera të eliminimit, me përjashtim të çështjes së certifikimit CE Klasa IIA, përbëjnë çështje të gjykuara (“Res Judicata”) përmes vendimeve paraprake (të lartpërmendura) të Panelit Shqyrtues të OSHP-së. Për rrjedhojë, në vijim eksperti do të elaborojë dhe do të japë mendim profesional ekskluzivisht për pretendimin ankimor që ka të bëjë me certifikatën CE Klasa IIA, duke qenë se kjo pikë nuk është trajtuar dhe nuk është vendosur më parë.

Pretendimi ankimor lidhur me certifikatën CE Klasa IIA

GOE ankues pretendon se arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht certifikatën që dëshmon se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe komunikimit të fotografive është e certifikuar me CE Klasa IIA sipas Direktivës së Pajisjeve Mjekësore 93/42 EEC, ku GOE pretendon se ka ofruar certifikatën që përmbushë dhe tejkalon kërkesën e AK-së.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor

AK në Njoftimin mbi vendimin të publikuar me datë 13.10.2025, thekson: “Ministria e Shëndetësisë anulon aktivitetin e prokurimit për mungese të ofertave të përgjegjshme, bazuar në rekomandimin e komisionit profesional të Ri-vlerësimit. AK-MSh e ka zbatuar vendimin e OSHP-se nr. 2025/1075 të datës 16.01.2026 duke e kryer Rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit. Komisioni vlerësues ka rekomanduar anulimin e aktivitetit duke konstatuar se oferta GOE PACS and Workflow System është e papërgjegjshme si në aspektin administrativ ashtu edhe në aspektin teknik. Më tej, në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar është dhënë arsyetimi për eliminimin e së GOE ankues, ku thuhet: “Oferta juaj është e papërgjegjshme, komisioni vlerësues në raportin e vlerësimit i ka potencuar arsyet e eliminimit të ofertës tuaj si në vijim: Lidhur me kërkesën për Kapacitetin teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Një certifikatë e vlefshme që dëshmon se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe komunikimit të fotografive është e certifikuar me CE Klasa IIA sipas Direktivës së Pajisjeve Mjekësore 93/42 EEC. – shih kriterin e DT. 2. Në kuadër të vlerësimit të kapacitetit teknik dhe profesional, në kuptim të nenit 69 të LPP-së. dosja e tenderit ka përcaktuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të detyrueshme si kriter kualifikues dorëzimin e një certifikate të vlefshme që vërteton se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe komunikimit të fotografive është e certifikuar me CE Klasa IIA, në përputhje me Direktivën e Pajisjeve Mjekësore 93/42/EEC. Kjo kërkesë përbën kusht thelbësor të pjesëmarrjes dhe nuk lë hapësirë për interpretim të zgjeruar apo për pranimin e dokumentacionit alternativ. Pra, dosja e tenderit kërkon një certifikatë të caktuar si dëshmi kualifikuese/teknike; ajo bëhet pjesë e kushteve detyruese dhe, sipas nenit 59(4) të LPP dhe nenit 40.6(b) të RRPP, tenderi është i përgjegjshëm vetëm nëse përputhet plotësisht me kërkesat e dosjes së tenderit. Megjithatë, Operatori Ekonomik ka dorëzuar certifikatë CE Klasa IIB, e cila përfaqëson një klasifikim të ndryshëm rregullator, me procedura të veçanta të vlerësimit të konformitetit dhe me status juridik të pavarur nga Klasa IIA. Edhe pse të dyja klasat rregullohen nga e njëjta direktivë, ato nuk janë të ndërsjella dhe as të zëvendësueshme, pasi certifikimi në një klasë nuk nënkupton automatikisht përmbushjen e kërkesave të klasës tjetër.”

AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën si vijon: “OE do të dorëzojë një sistem të propozuar të arkivimit dhe komunikimit të fotografive i cili do të certifikohet si të paktën CE Klasa IIA sipas Direktivës së Pajisjeve Mjekësore 93/42 EEC.”. Më tej AK ka përcaktuar dëshminë dokumentare që OE duhet ta dorëzojë për këtë kërkesë është: “Një certifikatë e vlefshme që dëshmon se zgjidhja e propozuar për sistemin e arkivimit dhe komunikimit të fotografive është e certifikuar me CE Klasa IIA sipas Direktivës së Pajisjeve Mjekësore 93/42 EEC.”

GOE ankues në ofertën e tij kishte dorëzuar dokumentin me emërtimin “4.1.Declaration and Certificate CE IIB”, ku në faqen e parë është deklarata e anëtarëve të grupit (Novus dhe Sorsix) ku GOE deklaroi se produkti i tyre "PACS and Workflow System" tejkalon kërkesat e tenderit (i

cili kërkonte Klasën IIA) duke ofruar një certifikatë më të lartë, CE Klasa IIB. Ata theksojnë se zgjidhja e tyre ka standarde më të larta sigurie dhe cilësie, sepse certifikimi për Klasën IIB kërkon një vlerësim më rigoroz dhe të detajuar, duke qenë se këto pajisje përdoren për situata mjekësore me rrezik dhe kritikshmëri më të madhe. Faqja e dytë e dokumentit përmban Certifikatë të Bashkimit Evropian për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë lëshuar nga trupa gjermane TÜV Rheinland për prodhuesin UAB Softneta, e cila dëshmon se softueri mjekësor i ofruar për instrumente të bioimazherisë dhe radioterapisë është kategorizuar si pajisje e Klasës IIB dhe përmbush plotësisht kërkesat e Rregullores së re Evropiane (BE) 2017/745 (MDR). Përmes këtij dokumenti, i cili mban numrin e regjistrimit HZ 1992126-1 dhe numrin e raportit 84947045-50, vërtetohet se prodhuesi zbaton një sistem cilësie që i nënshtrohet auditimit periodik nga autoritetet evropiane, ndërsa vlefshmëria e certifikatës shtrihet nga data 2 qershor 2021 deri më 22 tetor 2025.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor

Lidhur me këtë çështje, fillimisht eksperti sqaron se Rregullorja (BE) 2017/745 (MDR), e miratuar në vitin 2017 dhe e cila ka hyrë në zbatim të detyrueshëm dhe të plotë në maj 2021, ka zëvendësuar dhe shfuqizuar Direktivën 93/42/EEC (MDD) të aprovuar në vitin 1993. Linku i rregullores zyrtare (EUR-Lex): <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017R0745>.

Për të sqaruar këtë çështje nga ana profesionale, mjafton të elaborohen kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren (BE) 2017/745 (MDR), nga ku lehtësisht konstatohet se certifikimi i Klasës IIB sipas Rregullores së re (MDR) tejkalon kërkesën e dosjes së tenderit për "të paktën Klasën IIA sipas Direktivës 93/42/EEC (MDD)". Së pari, Rregullorja e re evropiane (MDR) ka zëvendësuar plotësisht direktivën e vjetër dhe vendos kërkesa më të rrepta për gjurmueshmërinë dhe mbikëqyrjen. Së dyti, vetë teksti i Rregullores (MDR) specifikon qartë dallimet në kriteret, ku sipas Nenit 52, Paragrafi 6, vlerësimi për pajisjet e Klasës IIA bëhet me mostrim të gjerë, duke përcaktuar se procedura "përfshin një vlerësim të dokumentacionit teknik [...] të paktën për një pajisje përfaqësuese për secilën kategori pajisjesh".

Ndërkaq, për pajisjet e Klasës IIB, procedura është shumë më rigoroze, përkatësisht sipas Nenit 52, Paragrafi 4, mostrimi ngushtohet dukshëm pasi kërkohet auditim "të paktën për një pajisje përfaqësuese për secilin grup pajisjesh gjenerike", ndërsa për pajisje me rrezik edhe më të theksuar të kësaj klase specifikohet qartë se "vlerësimi i dokumentacionit teknik zbatohet për çdo pajisje", pa lejuar asnjë lloj mostrimi. Për më tepër, certifikimi i pajisjeve të Klasës IIB kërkon një nivel shumë më të thellë të evidencës klinike dhe, në raste të caktuara, detyron përfshirjen e një Paneli të Pavarur Ekspertësh evropianë; konkretisht sipas Nenit 54, Paragrafi 1, theksohet se "për pajisjet aktive të klasës IIB të destinuara për të administruar dhe/ose hequr një produkt mjekësor [...] organi i njoftuar zbaton procedurën e konsultimit të vlerësimit klinik", një kontroll që nuk aplikohet për Klasën IIA.

Si përfundim, eksperti sqaron se dëshmia (certifikata) e ofertuar përputhet me rregullativën më të re të Bashkimit Evropian, i është nënshtuar një procesi vlerësimi shumë më të detajuar, duke dëshmuar se zgjidhja është profesionalisht dhe ligjërish më e avancuar kundrejt pragut minimal të përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit ("të paktën Klasa IIA sipas Direktivës 93/42/EEC"). Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

**- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -**

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, implementimi dhe mirembajtja e sistemit Packs dhe RIS te SISH” me nr. të prokurimit: "206-23-13309-1-1-1".

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues vlerëson se kjo lende është trajtuar me vendimet e Panelit Shqyrtues ku janë nxjerrur katër vendime nr; 2025/1075, 2025/0548, 2025/0060 dhe 2024/0712, andaj e konsideron si çështje të gjykuar ankesën ( Res Judicate) , sikurse parashihet në nenin 16.3 të Rregullores së punës , ne kuptim të nenit 105.2.16 të LPP-se.

Paneli Shqyrtues konstaton se kjo procedurë prokurimi është iniciuar më datën 29.11.2023, që nënkupton se procesi është duke u zhvilluar për një periudhë mbi dy vite e gjashtë muaj. Pas analizimit të rrjedhës procedurale, Paneli vlerëson se vonesat e pajustificueshme (prolongimi) i atribuhen ekskluzivisht Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht, kërkohet nga Autoriteti Kontraktues që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik . Njoftohet AK-ja se, në rast të mosveprimit të mëtutjeshëm apo shkeljes së afateve, Organi Shqyrtues i Prokurimit do të jetë i detyruar të iniciojë procedurë disiplinore, në përputhje me dispozitat e LPP-së, dhe Rregulloren e Punës së OSHP-së nr. 83/20.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e

prezantuarë si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahimi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - NOVUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: